

Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY

AKT PËRCJELLËS

Për:	Paneli Shqyrtues - OSHP	Kopje:	Paneli Shqyrtues - OSHP
Prej:	Safije Saramati – ekspert Shqyrtues Zenel Hisenaj – Ekspert Teknik		
Lënda:	Raporti i ekspertizës, lidhur me Lenden me Nr. 342/19 të parashtruar nga OE “Eor Group” shpk		
Datë	04. 07. 2019		

Bazuar në nenin 114 të Ligjit Nr. 04/L-042 i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/ L-068, dhe Ligjin 05/ L-092, ju njoftojmë me raportin, lidhur me ankesën e dt: **25.06.2019** me nr. **342/19** të parashtruar nga OE “**Eor Group**” shpk, lidhur me aktivitetin e prokurimit “**Furnizim me telefona mobil per nevojat e AKK-se**” me nr. të prokurimit: **623-19-3414-1-3-6**, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – **Agjencia Kundër Korrupsion**.

AK është i thirrur që pas marrjes së raportit të ekspertit shqyrtues lidhur me këtë kërkesë, të veprojë sipas kërkesave të nenit 115 të LPP-së.

Të bashkangjitur gjeni raportin e ekspertit shqyrtues.

Ti dorëzohet:



- Autoritetit Kontraktues – **Agjencia Kundër Korrupsion**.
- Panelit Shqyrtues – OSHP
- OE ankues **Eor Group**” shpk

Raporti i ekspertizës, lidhur me ankesën e parashtruar nga OE “**Eor Group**” shpk, lidhur me aktivitetin e prokurimit “**Furnizim me telefona mobil per nevojat e AKK-se**” me nr. të prokurimit: **623-19-3414-1-3-6**, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – **Agjencia Kundër Korrupsion**.



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY

RAPORTI I EKSPERTIT TEKNIK

 		17.06.2019	04.07.2019
Nënshkrimi i ekspertit		data e autorizimit të ekspertit.	data e dorëzimit të raportit

N. 105, LPP - Baza ligjore e shqyrtimit

1). Me datën: **03.06.2019** OE “Eor Group” shpk ,ka parashtruar ankesë në OSHP, lidhur me aktivitetin e prokurimit “Furnizim me telefona mobil për nevojat e AKK-se” me nr. të prokurimit: **623-19-3414-1-3-6**, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – Agjencia Kundër Korrupsion.

Konform nenit 113, 114 të Ligjit Nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/ L-068, dhe Ligjin 05/ L-092, Eksperti Shqyrtues dhe teknik i kane shqyrtuar pretendimet ankimore të OE ankues.

Operatori Ekonomik Ankues “Eor Group” shpk - Prishtinë.

Dispozitat e shkelura sipas OE ankues ““Eor Group” shpk,:

- Neni 7 i LPP-se
- Neni 59 i LPP-se
- Neni 60 i LPP-se

DEKLARATA DETALE MBI FAKTET DHE ARGUMENTET:

Kërkojmë nga OSHP-ja që kërkesën tonë të shqyrtojë duke u thirrur në LPP-në, pasi që në bazë të kërkesave të Dosjes se tenderit ne i plotësojmë të gjitha kërkesat e dhëna me DT.
Duke marrë për bazë

LIGJI NR. 05 L-092 PER NRYSHIMIN DHE PLOTESIMIN E LIGJIT NR 04L/042 PER PROKURIMIN PUBLIK TE REPUBLIKES SE KOSOVES I NDRYSHUAR DHE PLOTESUAR ME LIGJ SI DHE DUKE U BAZUAR NE RRUOPP

Në rastin e lartë cekur është marr një vendim jo i drejt, pasi që përshkrimin teknik i dhënë nga AK dhe nga per

Raporti i ekspertizës, lidhur me ankesën e parashtruar nga OE “Eor Group” shpk, lidhur me aktivitetin e prokurimit “Furnizim me telefona mobil per nevojat e AKK-se” me nr. të prokurimit: **623-19-3414-1-3-6**, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – Agjencia Kundër Korrupsion.

group shpk është për te njëjtat produkte, pra smartphone Iphone 7 plus dhe Iphone X.

Nëse nuk është kështu pra Autoriteti Kontraktues e te na tregoi se për çfarë tipi të smartphonve që gjinden në treg janë dhënë përshkrimet teknike sipas përshkrimit në Anexin 1 të DT?!!!.

Për ndryshe me justifikimin e dhënë nga Autoriteti Kontraktues kinse nuk po i plotësoja kërkesat e dhëna me Anexin 1 SPECIFIKIMET TEKNIKE TE DETYRUESHME, -për Çdo ditë e me tepër po i vështirësojnë mundësinë e Operatorëve Ekonomik që të trajtohen sipas LPP-së, Neni 7- Barazia në Trajtim/ Jo-Diskriminimi dhe Transparenca dhe Neni 59- Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahësimi i Tenderëve pasi që me këtë Lloj të ekzagjeruar të përshkrimeve teknike qëllimi/parapërgatitje është mënyrë për të favorizuar ndonjë Operator Ekonomik, dhe në këtë mënyrë Autoriteti Kontraktues po favorizon Operator Ekonomik. Në këtë mënyrë po keq interpretohet LPP-ja ku AKK-ja ka shkëlur pa dashje apo me dashje dispozitat e LPP-së (Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës).

Gjithnjë duke parapërgatitur Anex 1 SPECIFIKIMET TEKNIKE Të DETYRUESHME dhe përshkrimet teknike që të përdoren si shkas kinse mos plotësimin e të gjitha kriterëve të dhëna me Anex 1 ,përdoren nga AK të eliminonjë Operatoret Ekonomik.

Duke u bazuar në faktet e lartë cekura, kërkojmë nga OSHP-ja që të kërkojë nga AK të ri-shqyrtoj kërkesën tonë dhe ta anuloi vendimin e datës 17.06.2019 për ANULIM dhe të ri-shqyrtojë kërkesën dhe të shpall vendimin e ri ku EOR GROUP SHPK shpërblehet me kontratë pasi që i plotësojmë të gjitha kërkesat e dhëna me njoftim për kontratë dhe DT.

Procesi i prokurimit:

Data e njoftimit për kontratë:21.05.2019

Lloji i procedurës së aplikuar:.....Kuotim Çmimi

Lloji dhe vlera e kontratës së publikuar:.....Kontratë publike, Furnizim

Vlera e parashikuar e kontratës:.....5,000.00 €

Kriteri për dhënie të kontratës(N.52)..... Çmimi më i ulët

Afati i fundit për dorëzimin e ofertave.....29.05.2019

Kriteret për vlerësim:

III.2.1 Kërkesat e përshtatshmërisë

1. Kërkesa 1- Operatori Ekonomik duhet të përmbushë kërkesat e specifikuara në nenin 65 të Ligjit të Prokurimit Publik (LPP), Ligji nr 04 L-42. LPP mund të shkarkohet nga <http://krpp.rksgov.net>

Dëshmia e kërkuar dokumentare

1. Dëshmia 1. Një deklaratë e shkruar nën Betim, e nënshkruar nga tenderuesi duke përdorur formën e përcaktuar në dosjen e tenderit Aneksi 2.

III.2.2) Përshtatshmëria profesionale:

1. Kërkesa 1. Regjistrimi si operator ekonomik në regjistrin profesional, komercial dhe apo Regjistrin e ndërmarrjeve në vendin e juaj të themelimit;
2. Kërkesa 2 Regjistrimi i TVSH – së.

Dëshmia e kërkuar dokumentare

1. Evidenca 1. Certifikata e regjistrimit të biznesit-kopje
2. Evidenca 2. Certifikatën e TVSH – Kopje.

III.2.4) Kapaciteti teknik dhe profesional

1. Kërkesa 1. Operatori ekonomik duhet të ofrojë dëshmi se ka kryer me sukses së paku një furnizim të ngjashëm gjatë tri viteve të shkuara deri në publikimin e njoftimit për kontratë.
2. Kërkesa 2. Katalog ose fotografi me ngjyra se bashku me përshkrimin teknik për artikullin që ofertoni.

Dëshmia e kërkuar dokumentare

1. Evidenca 1. Kur furnizimet janë kryer për një autoritet publik në Kosovë ose në një vend tjetër, për dëshmi duhet të dorëzohet certifikata – raporti i pranimi të furnizimeve ose referenca të lëshuar nga autoriteti i tillë. Kur furnizimet janë kryer për një blerës privat, kopja e çdo dokumenti që ka të shënuar llojin e furnizimeve të kryera dhe është i nënshkruar nga blerësi dhe furnizuesi.
2. Evidenca 2. Katalog ose fotografi me ngjyra se bashku me përshkrimin teknik për artikullin që ofertoni .

Regjistri i ofertuesve sipas procesverbalit të hapjes publike:

Nr	Operatorët Ekonomik	Vendi	Çmimi €	Vërejtje
1.	“Cimi @ Electronic” shpk	Skenderaj	4820,00 €	JO
2.	“Eor Group” shpk	Prishtinë	4444,00 €	JO
3.	“InterAdria” shpk	Prishtine	4736.00 €	JO
4.	“Albus” shpk	Prishtine	4990.00 €	JO

Komisioni vlerësues pranë AK:

Përbërja dhe kualifikimi i komisionit vlerësues.

Autoriteti Kontraktues për vlerësimin e tenderëve ka caktuar komisionin në përbërje, si në vijim:

- Almedine Tolaj– Kryetar i komisionit
- Sabrije Bulaltovci – Anëtar i komisionit
- Qëndresa Berisha – Anëtar i komisionit
- Besnik Dragusha – Anëtar i komisionit
- Arian Buçaj – Anëtar i komisionit

Raporti i komisionit vlerësues:

Kërkesa 2. Katalog ose fotografi me ngjyra se bashku me përshkrimin teknik për artikullin që ofertoni.

"cimi @ ELECTRONIC " SH.P.K.	Eor Group SH.P.K.	" INTERADRIA " L.L.C.	"ALBUS" SH.P.K.
I papajtueshëm	I papajtueshëm	I papajtueshëm	I papajtueshëm

Përgjigje në pretendimin ankimore të OE ankues Eor Group SH.P.K. -Prishtinë.

Përgjigje për pretendimin 1

Arsyeja e Eliminimit të OE qëndron në faktin se i njëjti në ofertën e tij nuk ka paraqitur “Katalog ose fotografi me ngjyra se bashku me përshkrimin teknik për artikullin që ofertoni.” Sipas

Përgjigje në Pretendimin Ankimor

Bazuar në dosjen e Tenderit përkatësisht Specifikimi teknik si dhe Ofertës së OE Ankuese rezulton se i njëjti në dosjen e tij, ka të bashkangjitur Broshurën për Pajisjet e kërkuara dhe të njëjtat plotësojnë specifikimin teknik sipas kërkesës

Modeli 1 = Oferta e OE është IPHONE 7 Plus 32GB gjë që plotëson të gjitha specifikat sipas kërkesës

Modeli 2 = Oferta e OE është IPHONE X 64GB gjë që plotëson të gjitha specifikat sipas kërkesës

Andaj në bazë të të gjitha shkresave për këtë lëndë konsideroj se Ankesa është e Bazuar dhe lënda të kthehet në Rivlerësim.

Mendimi i ekspertit Teknik

Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues/teknik i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues të aprovet si e bazuar, dhe ky aktivitet i prokurimit të kthehet në Rivlerësim.

Raporti i ekspertizës, lidhur me ankesën e parashtruar nga OE “Eor Group” shpk, lidhur me aktivitetin e prokurimit “Furnizim me telefona mobil për nevojat e AKK-se” me nr. të prokurimit: 623-19-3414-1-3-6, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – Agjencia Kundër Korrupsion.